



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:068029

Datë: 08.04.2024

Numri i dokumentit: 05554897

E.nr.804/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit M.A., nga Shtimja, të cilin e përfaqëson av Islam Gashi nga Lipjani, kundër debitorit Komuna e Shtimes - Drejtoria e Arsimit, për pagesën pagave jubilarë, ushqimit dhe udhëtimit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 08.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbarimore në lëndën **E.nr.804/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.804/23, të datës 22.05.2023, e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Komuna e Shtimes - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e pagave jubilarë, ushqimit dhe udhëtimit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit 2021:068030, të datës 03.09.2021.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 03.10.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 1,884.12 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e tij, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.804/23, më datë 08.04.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi